

KORONAVIRUSI I RI COVID -2019

INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

KORONAVIRUSET

- Koronaviruset (CoV) jane nje familje e madhe virusesh qe shkaktojne semundje nga me te lehtat deri tek ato teper te renda
- Ata jane te perhapur tek shume specie te kafsheve
- Rralle evolojne ,transmetohen dhe infektojne njerezit dhe me pas perhapen midis tyre
- Koronaviruset humane u identifikuan per here te pare ne vitin 1960
- Deri ne vitin 2019 njiheshin 6 te tille nga te cilet 4 te zakonshem si 229 E (alpha coronavirus), NL63 (alpha coronavirus, OC43 (beta coronavirus dhe HKU1 (beta coronavirus)
- Ne shekullin e 21 dy koronavirus me patogenitet te larte si:
  - SARS CoV qe shkakton Sindromen Respiratore Akute te Rende dhe
  - MERS-CoV qe shkakton sindromin respirator te Lindjes se Mesme

U transmetuan nga rezevuare te kafsheve si macet e egra dhe gamiliet tek njerezit duke shkaktuar epidemi globale me semundshmeri dhe vdekshmeri te larte



SARS



MERS



COVID-2019

KORONAVIRUSI COVID-2019

- COVID-19 eshte nje semundje infektive e shkaktuar nga koronavirusi I ri

- Koronavirusi i ri dhe semundja ishin te panjohur deri para shperthimit epidemik ne Wuhan, Kine, Dhjetor 2019

- 31 Dhjetor 2019- raste me pneumoni ne Wuhan, provinca Hubei, Kine ku shumica e tyre raportonin ekspozim ne nje treg te madh te produkteve te detit ku shiteshin shume specie te kafsheve te gjalla

Transmetimi

- Periudha e inkubacionit eshte koha nga renia ne kontakt me virusin deri ne shfaqjen e shenjave
- Per COVID-19 eshte 1-14 dite, zakonisht 5 dite
- Virusi perhapet nga nje person i infektuar
- Transmetimi kryhet nga personi ne person nepermjet sperklave qe perhapen gjate teshtimave apo kollitjes
- Prandaj duhet te qendrohet mbi 1 meter larg nje personi te prekur
- Sperklat perhapen ne ajer dhe mund te qendrojne ne siperfaqe te objekteve
- Prekja e ketyre objekteve te ndotura dhe ferkimi i hundes , syve dhe gojes mund te transmetoje virusin
- Prandaj eshte e rendesishme larja e shpeshte e duarve dhe pastrimi i siperfaqeve te objekteve
- Nuk transmetohet nga ajri (jo aerogen)



Sa jeton ?

- Akoma nuk eshte e qarte sa jeton ne siperfaqe te objekteve
- Duke u nisur nga koronaviruset e tjere kjo kohe shkon nga disa ore ne disa dite
- Mbijetesa e virusit varet nga lloji I siperfaqes, temperaturae jashtme, lageshtia e mjedisit

Shenjat klinike

- Temperature
- Lodhje, dobesi trupore
- Kolle e thate

Mund te kete edhe

- Dhimbje muskulare,koke
- Rrjedhje nga hundet
- Dhimbje fyti ose diarre

- Shenjat fillojne gradualisht
- Ne disa raste eshte pa shenja klinike
- 80% e persona sherohen pa ndonje trajtim
- Semundje te rende zhvillojne persona e moshuar, me semundje zemre, diabet HTA
- Personat me temperature, kolle dhe veshtiresi ne frymemarrje duhet te kerkoje ndihme mjeksore

Perkufizimi i rastit per Survejancën e COVID-19

Përkufizimi i rastit bazohet në informacionin e deritanishëm dhe mund të rishikohet, kur të ketë një informacion tjetër të ri

- Kritere klinike dhe epidemiologjike

➢ Rast i dyshuar
➢ Rast i mundshem
➢ Rast i konfirmuar

Rast i dyshuar- Kritere klinike dhe epidemiologjike

Çdo person me:

- Infeksion akut të traktit respirator (fillim i menjëhershëm i temperaturës dhe të paktën një prej shenjave të mëposhtme të sëmundjes respiratore si p.sh. kollë, vështirësi në frymëmarje)

  DHE pa etiologji tjetër që të shpjegojë plotësisht paraqitjen klinike

  DHE me një histori udhëtimi ose qëndrimi në një vend apo zonë që ka raportuar transmetim lokal ose komunitar*, gjatë 14 ditëve përpara fillimit të shenjave klinike

- Sëmundje akute respiratore **DHE** që ka qenë në kontakt të ngushtë me një rast COVID -19 të mundshëm apo të konfirmuar gjatë 14 ditëve të fundit, përpara fillimit të shenjave klinike

- Sëmundje respiratore e rëndë akute (temperaturë dhe të paktën një shenjë të sëmundjes repsiratore p.sh. kollë, vështirësi në frymëmarje) **DHE** që kërkon hospitalizim (SRRA ose STRA*) **DHE** pa etiologji tjetër që të shpjegojë plotësisht paraqitjen klinike
- *Klinicistët duhet të jenë në gatishmëri për të parë edhe mundësinë e paraqitjeve atipike në pacientë me imunitet të kompromentuar.*
- ***Testimi laboratorik për COVID-19 duhet të kryhet për të gjitha rastet e dyshuara, bazuar në kriteret e përshkruara më lart***

Rast i mundshem

Një rast i dyshuar për të cilin testimi për virusin që shkakton COVID-19 nuk është përfundues

(sipas rezultateve të testit të raportuara nga laboratori)

ose rezulton pozitiv gjatë testimit me testin për pan -coronavirus

Rast i konfirmuar

Çdo person për të cilin ka konfirmim laboratorik për virusin që shkakton COVID-19 pavarësisht shenjave klinike

Testi jopërfundues për COVID-19 përsëritet edhe nëse është përsëri jopërfundues.
Në këtë rast mostra do të dërgohet menjëherë pranë Institutit të Virologjisë, Charite, Berlin,Gjermani apo çdo qendër tjetër të përcaktuar nga zyra europiane e OBSH-së për konfirmim

Përkufizimi i kontaktit

***Kontakt përbën çdo person si në rastet më poshtë*:**

- Ka ofruar apo ofron direkt kujdes shëndetësor për pacientët me COVID-19 pa mjetet e duhura të mbrojtjes personale (MMP)
- Ka qëndruar apo qëndron në të njëjtin mjedis të ngushtë me pacientin me COVID-19 (shtëpi, shkollë, vend pune, zyrë, tubim)
- Ka udhëtuar së bashku me një pacient me COVID-19 dhe ka qenë në afërsi me të (në një distancë prej 1 m) në çdo mjet udhëtimi brenda 14 ditëve të fillimit të shenjave të sëmundjes të rastit që merret në konsideratë

Kontakte të ngushta të rastit të dyshuar ose të konfirmuar:

- Një person që jeton në të njëjtën shtëpi me një rast me COVID-19
- Një person që ka patur kontakt direkt fizik me një rast me COVID-19 (p.sh. shtrëngimi i duarve)
- Një person që ka patur kontakt direkt të pambrojtur me sekrecionet e një rasti me COVID-19
- Një person që ka patur kontakt ballë për ballë me një rast me COVID-19 brenda 2 metrave dhe në më shumë se 15 minuta
- Një person që ka qenë në një mjedis të mbyllur (p.sh. klasë, zyrë, dhomë mbledhjeje, mjedis apo dhomë pritjeje në spital etj.) me një rast me COVID-19 për 15 minuta ose më shumë, dhe në një distancë me më pak se 2 metra

Kontakte të ngushta të rastit të dyshuar ose të konfirmuar

- Një punonjës shëndetësor ose person tjetër që ofron kujdes shëndetësor apo kujdes direkt për një rast me COVID-19,
- OSE punonjës laboratori që merret me manipulimin e mostrave të rastit me COVID-19 pa MMP-në e rekomanduar,
- OSE që ka dëmtim të MMP-së apo rregullave të përdorimit të tyre

- Një kontakt në një avion ku personi është ulur brenda dy vendeve në çdo drejtim të rastit me COVID-19, shokë udhëtimi ose persona që ofrojnë kujdes, si dhe anëtarët e stafit të avionit që shërbejnë në atë seksion të avionit ku ka qenë ulur rasti i caktuar apo indeks.

- Nëse shenjat apo lëvizjet e rastit tregojnë për një ekspozim më të gjerë, pasagjerët e ulur në të gjithë seksionin ose të gjithë pasagjerët e avionit mund të konsiderohen kontakte të ngushta.

- *Kujdes duhet të kemi dhe për çdo person që është një punonjës shëndetësor i cili ka qëndruar apo punuar në një mjedis ku është ofruar kujdes për raste me infeksione të rënda respiratore akute, me etiologji të panjohur.*

Njoftimi

- Çdo rast i dyshuar, i mundshëm ose i konfirmuar me COVID-19 duhet të raportohet pranë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) përkatëse menjëherë, dhe më pas prej NJVKSH-së ose menjëherë pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) me formularin rutinë të njoftimit
- Kjo procedurë duhet të kryhet menjëherë dhe brenda 24 orëve

- Çdo rast duhet të hetohet sipas udhëzimit përkatës dhe të plotësohet skeda përkatëse e hetimit per COVID -19 brenda 24 orëve.
- Gjithashtu, duhet të hetohen kontaktet sipas udhëzuesit përkatës

- Çdo **individ që raporton çfarëdolloj** kontakti me një rast të dyshuar, të mundshëm ose të konfirmuar me COVID-19 duhet të raportohet pranë NJVKSH-së përkatëse menjëherë, dhe më pas, prej NJVKSH-së pranë ISHP-së me formularin e hetimit. Kjo procedurë duhet të kryhet menjëherë dhe brenda 24 orëve


PACIENTI
URGJENCA
127
NJVKSH
KESHILLIM
SPITALI INFEKTIV
SUSM
SH. NDROQI
SKEDA
MOSTRA
SKEDA
MOSTRA
SKEDA
MOSTRA
ISHP
MSHMS

Raportimi i rasteve

- Cdo rast i dyshuar duhet të trajtohet sipas procedurës së përgjithshme bazuar në ligjin 15/2016 për sëmundjet infektive

- Të gjithë mjekët e qendrave shëndetësore që trajtojnë një pacient që plotëson përkufizimin e një rasti të dyshuar apo të mundshëm, duhet të njoftojnë sipas ligjit 15/2016 dhe të kontaktojnë mjekun infeksionist dhe Qendrën Kombëtare të Urgjencës/ telefon 127, nëse rasti duhet të paraqitet apo të shtrohet në spital

- Nëse pacienti kontakton sistemin e kujdesit shëndetësor parësor (mjekun e familjes, Qendrën Kombëtare të Urgjencës Shëndetësore 127), këshillohet që të mos e drejtoni menjëherë në urgjencë, por të organizoni kujdesin e tij me masat e mëposhtme në mënyrë që të shmanget kontakti me pacientët e tjerë, madje edhe në mungesën e shenjave në favor të transmetimit nga njeriu tek njeriu. Po ashtu organizohet dhe marrja e mostres ne banese apo ne qendren shendetesore nga NJVKSH

- Masat paraprake higjienike duhet të vendosen menjëherë kur kemi një rast të dyshuar, qoftë në një qendër shëndetësore, qoftë në një mjedis spitalor.
- Në përgjithësi, duhet të kihet parasysh që nëse ndodh në Qendrën Shëndetësore (vizita, konsultime, etj.) pacientit që paraqet shenja respiratore infektive, në veçanti kollë, duhet t'i vendoset menjehërë një maskë mjekësore respiratore, si dhe personeli shëndetësor duhet të sigurojë mbrojtjen e tij (maskë, syze dhe higjienën e duarve)

- Një mjek që kujdeset për një pacient (hallka e parë në zinxhirin e kujdesit) ka mundësinë e përjashtimit të rastit për të cilin shenjat klinike ose ekspozimi nuk korrespondon në mënyrë të qartë me përkufizimin e rastit.
- Nëse është e nevojshme, ai mund të mbështetet në një ekspertizë kolegjiale përmes një konsulte, veçanërisht nga specialistët e ISHP-së dhe mjekun infeksionist.

Menaxhimi i rastit

Që në klasifikimin si rast i dyshuar dhe më pas rast i mundshëm, mjeku që trajton pacientin duhet ta raportojë atë menjëherë sipas ligjit 16/2016 me telefon, whats up, e-mail etj. pranë:

- Shërbimit të epidemiologjisë të NJVKSH-së dhe NJVKSH-së pranë ISHP-së;
- ose direkt në ISHP
- Po ashtu ai duhet të lajmërojë drejtuesit e tij, shërbimin e kontrollit të infeksionit dhe nëse vendos të transportojë rastin në shërbimin infektiv edhe shërbimin e infektivit, si dhe urgjencën mjekësore në numrin 127.
- Në rast të klasifikimit të një pacienti në një rast të mundshëm apo të konfirmuar, ISHP-ja menjëherë ia raporton atë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Për rastet e dyshuara, mostrat respiratore ose të gjakut duhet të merren sipas protokollit përkatës dhe të dërgohen pranë Laboratorit të Virologjisë në ISHP, sipas procedurave të përshkruara.
- Në pritje të të dhënave epidemiologjike, virologjike dhe klinike më të detajuara është e nevojshme të zbatohet monitorimi i çdo rasti të klasifikuar si i dyshuar apo dhe i mundshëm.

Menaxhimi i kontakteve dhe personave të ekspozuar ndaj një rasti të dyshuar dhe të mundshëm

Sa më shpejt të jetë e mundur, NJVKSH-ja në bashkëpunim me ISHP-në fillon identifikimin e personave që kanë patur të njëjtin ekspozim si rasti i dyshuar apo i mundshëm (subjekte të ko- ekspozuara) dhe subjekteve që kishin kontakt të ngushtë me rastin gjatë periudhës së tij simptomatike ose dhe përpara shfaqjes së shenjave klinike.

- Në pritje të konfirmimit të rastit, çdo kontakt duhet të mbahet në vetëkarantinë ose karantinë
- Pas konfirmimit të rastit, kontaktet duhet të qëndrojnë në vetëkarantinë apo karantinë sipas gjykimit të rastit për të siguruar distancimin social të tyre, duke zbatuar rregullat e karantinës.
- Vetekarantina gjykohet nga NJVKSH ne bashkepunim me ISHP duke vleresuar kushtet e banimit, personat dhe mundesite e tyre etj.
- Ne rast se NJVKSH gjykon se keto kushte nuk plotesohen atehere kryhet karantina e detyruar per 14 dite ne mjedisin e percaktuar.

Menaxhimi i një rasti të konfirmuar

- Në rast të një klasifikimi të një rasti të mundshëm në një rast të konfirmuar, laboratori i sëmundjeve emergjente virale në ISHP informon mjekun kurues të pacientit

- Paralelisht, ISHP-ja informon edhe MSHMS-në

Menaxhimi i kontakteve dhe personave të ekspozuar asimptomatikë ndaj një rasti të konfirmuar

- NJKVSH-ja në bashkëpunim me ISHP-në kontakton rastet e ekspozuara dhe kontaktet e ngushta për t'i informuar ata në rast të shfaqjes së temperaturës ose shenjave respiratore, brenda 14 ditëve nga ekspozimi.
- Këta persona duhet të telefonojnë Qendrën e Urgjencës Mjekësore 127, për të marrë këshillat përkatëse dhe të mos shkojnë direkt te mjeku i tyre ose në urgjencë.

Trajtimi

- Deri tani nuk ka asnjë trajtim specifik për COVID-19, trajtimi është simptomatik apo kur ka nevojë ofrohet kujdes reanimator.

Marrja, ruajtja dhe transporti i mostrave

- Deri tani kampionet që do të analizohen me metodën molekulare të real-time PCR mund të jenë njësoj si kampionet për gripin sezonal të dyshuar
- Për sa i përket izolimit të virusit në kultura qelizore, kjo do të ishte e mundshme, por do të kërkonte një nivel më të lartë sigurie se ai që ne disponojmë.

Mostrat që duhet të grumbullohen:

- Mostra respiratore* (tampon nazofaringeal dhe orofaringeal, aspirat nazofaringeal apo shpëlarje nazale) nga pacientë ambulatorë, si edhe sputum nëse është e mundshme edhe /ose aspirate endotrakeale, lavazhe brokoalveolare apo sputum nga pacientët me infeksion të rëndë respirator akut (IRRA).
- Mostër serumi të gjakut për testim serologjik (faza akute dhe konvaleshente për 2-4 javë pas fazës akute) është mostër shtesë mbi ato respiratore, në momentin që testet serologjike do të jenë të gatshme
- Mostra të tjera të cilat duhet të merren në konsiderate janë gjaku, urina dhe fecet.
- *Të mos përjashtohet prania e infeksionit vetëm nga një test i vetëm që rezulton negativ,veçanërisht nëse është një mostër e traktit të sipërm respirator*
- *Të merret një mostër e dytë dhe të përsëritet testi me një mostër respiratore të traktit të poshtëm respirator, që rekomandohet në rastet kur sëmundja përparon mjaft shpejt në forma të rënda (IRRA) apo tepër të rënda të infeksiove respiratore akute (ITRRA)*
- **Një rezultat pozitiv për një patogen tjetër gjithashtu nuk përjashton prezencën e një koinfeksioni**.
- *Procedurat e sigurisë gjatë marrjes dhe transportit të mostrave*
- Të gjitha mostrat që do të hetohen duhet të trajtohen si mostra potencialisht infektuese, dhe punonjësit shëndetësorë që do të marrin ose transportojnë mostrat klinike duhet të zbatojnë me përpikmëri rregulloret e kontrollit dhe parandalimit të infeksionit, si edhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të substancave infektuese për të minimizuar rrezikun e ekspozimit ndaj patogenëve.
- *Identifikimi dhe kodifikimi i mostrave*
- Mostrat do të kodohen me të njëjtën mënyrë si janë kodifikuar mostrat e gripit, pra në mënyrë të përcaktuar nga ISHP-ja, dhe do të plotësohet informacioni i detajuar në skedën shoqëruese të mostrës.

Kujtesë për masat higjienike

- Masat paraprake të higjienës (shpesh të quajtura masa izolimi) duhet të vendosen sa më shpejt, kur rasti klasifikohet i dyshuar dhe/apo i mundshëm
- Është një kombinim i masave të lidhura me transmetimin ajror dhe masa paraprake shtesë të kontaktit.
- ***E rëndësishme*:** Para se të merrni mostrat ose të bëni një ekzaminim klinik, personeli shëndetësor siguron mbrojtjen e tij duke respektuar kombinimin e masave paraprake të lidhura me transmetimin ajror dhe masa paraprake shtesë të kontaktit.
- Për sa i përket dezinfektimit të materialeve, koronaviruset janë të ndjeshme ndaj :
- **hipokloritit të natriumit (zbardhuesit) me 0,1%,**
- **komponimeve organoklorur në 0,1%,**
- jodoforeve në 10%,
- etanolit në 70% dhe
- me glutaraldehid 2%,
- komponime të amoniumit quaternary 0.04% dhe derivateve fenolike
- **Mjetet e duhura të mbrojtjes personale**
- NJVKSH duhet te kene gjate marrjes se mostres detyrimisht maske respiratore, syze, doreza dhe perparese letre si dhe dezinfektante
- Pacienti transportohet ne spital nga personeli i cili eshte i pajisur veshjet e plota te mbrojtjes perosnale (kominoshe TYVEC, maske respiratore, syze, ose mbrojtese te fytyres, kembeza, doreza etj)

Masat mbrojtese

- Larja e shpeshte e duarve me uje dhe sapun ose pastrami me solucione me baze alkoli
- Qendroni mbi 1 meter larg nga personat qe kane shenja si kollitje apo teshtima
- Evitoni prekjen e syve, hundes dhe gojes
- Sigurohuni qe edhe njerezit rreth jush respektojne rregullat e higjenes
- Kur teshtini vendosni cepin e berrylit dhe jo duart
- Perdorni shami kur teshtini dhe hidheni me pas ate
- Qendroni ne shtepi nese nuk ndjeheni mire
- Nese keni shenja te semundjes kontakto mjekun
- Evitoni mbledhjet ne ambientet e mbyllura
- Mos perdorni maska nese nuk keni shenja
- Shmangni udhetimet ne vendet e prekura dhe kontaktet me persona qe vijne nga keto vende

Rekomandime

- *Të gjithë qytetarët që kanë udhëtuar nga vendet e prekura, të telefonojnë në numrin e Urgjencës Kombëtare 127 në rast të shfaqjes së çdo shqetësimi apo shenje klinike, pa u drejtuar menjëherë në spital për të minimuzuar rriskun e infektimit me viruset e tjera respiratore*
- *Qytetarët të cilët vijnë nga rajonet e prekura të vetë karantinohen për një periudhë prej 14 ditësh*
- *Qytetarët të cilët kanë udhëtuar në vendet e prekura dhe kanë shenjat e infeksionit viral, temperaturë, kollë dhe sidomos insuficiencë respiratore (vështirësi në frymëmarrje) të telefonojnë në numrin 127 për të marrë udhëzimet se si duhet të veprojnë*